



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 21 datë 29.4.2024

**“PËR MIRATIMIN E MASËS SË QIRASË MUJORE PËR BANESAT SOCIALE
ME QIRA NË ADMINISTRIMIN E BASHKISË SHKODËR
PËR VITIN 2024”**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 29.4.2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 24, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” të ndryshuar; nenit 30 pika 2, të ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social” të ndryshuar; pika 11, 13 e VKM nr.522 datë 25.07.2019 “Metodika e llogaritjes së masës së qirasë për banesat sociale me qira”, VKB nr.1 datë 22.01.2016 “Për taksat dhe tarifat vendore”, i ndryshuar; VKB nr.30 datë 03.06.2021 “Për miratimin e masës së qirasë mujore për banesat sociale me qira pranë Qendrës Komunitare “Për Familjen” nr. 6 për vitin 2021”, VKB nr.31, datë 03.06.2021 “Për miratimin e masës së qirasë mujore për banesat sociale me qira për komunitetin rom”, VKB nr.23 datë.10.5.2022 “Për miratimin e masës së qirasë mujore për banesat sociale me qira pranë ish-konviktit të shkollës Veterinare, e-mailin e datës 27.03.2024 të Institutit të Statistikave INSTAT mbi “Ndryshimin mesatar vjetor të indeksit të konsumit”, si dhe pas shqyrtimit të materialit të përgatitur nga administrata e Bashkisë.

V E N D O S I:

- 1. Të miratojë masën e qirasë mujore për banesat sociale me qira pranë Qendrës Komunitare “Për Familjen” nr. 6, për vitin 2024 si më poshtë:**

Qiraja mujore e apartamentit A me sipërfaqe 56.8 m²
 $3,316 + (3,316 \times 4,8\%) = 3,475$ Lekë/Muaj).

Qiraja mujore e apartamentit B me sipërfaqe 88.9 m²
 $5,191 + (5,191 \times 4,8\%) = 5,440$ Lekë/Muaj).

Qiraja mujore e apartamentit C me sipërfaqe 96.1 m²
 $5,611 + (5,611 \times 4,8\%) = 5,880$ Lekë/Muaj).

2. Të miratojë masën e qirasë mujore për banesat sociale me qira për komunitetin rom për vitin 2024, si më poshtë:

Qiraja mujore e apartamentit 1+1 me sipërfaqe 30 m²

$$1,900 + (1,900 \times 4,8\%) = 1,991 \text{ Lekë/Muaj.}$$

Qiraja mujore e apartamentit 2+1 me sipërfaqe 40 m²

$$2,500 + (2,500 \times 4,8\%) = 2,620 \text{ Lekë/Muaj.}$$

3. Të miratojë masën e qirasë mujore për banesat sociale me qira pranë ish-conviktit të shkollës Veterinare për vitin 2024 si më poshtë:

Qiraja mujore e apartamentit A 1+1 me sipërfaqe 33 m²

$$4,279 + (4,279 \times 4,8\%) = 4,484 \text{ Lekë/Muaj.}$$

Qiraja mujore e apartamentit B 1+1 me sipërfaqe 37 m²

$$4,729 + (4,729 \times 4,8\%) = 4,956 \text{ Lekë/Muaj.}$$

Qiraja mujore e apartamentit C 2+1 me sipërfaqe 55 m²

$$7,206 + (7,206 \times 4,8\%) = 7,552 \text{ Lekë/Muaj.}$$

Qiraja mujore e apartamentit D 2+1 me sipërfaqe 62 m²

$$8,107 + (8,107 \times 4,8\%) = 8,496 \text{ Lekë/Muaj.}$$

4. Të ardhurat e mbledhura nga qiratë e fondit publik të banesave sociale me qira do të derdhen në llogarinë ekonomike të Bashkisë Shkodër me kodin nr. 7109600 me emërtimin "Qira e ndërtesës" (nga banesat sociale me qira).
5. Të ardhurat e depozituara nga qiratë e banesave sociale me qira përdoren nga strukturat përgjegjëse të administrimit të banesave sociale me qira për mirëmbajtjen dhe administrimin e tyre dhe raportohet mbi përdorimin e fondit si pjesë e programit buxhetor nr. Programi 10661, Strehimi Social.
6. Niveli i qirasë i përcaktuar në pikat 1, 2 dhe 3 është i vlefshëm deri me 31.01.2025.
7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
8. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar.

KRYETAR

Oltion LULLI

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Denis Lesha

Miratuar me 30 vota

Vota Pro 30

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 7.5.2024

